



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 124/10 Prot.
2023

Tiranë, më 26 . 07 .

V E N D I M

Nr. 144 , Datë 26 . 07 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 16 Regj., datë 20.01.2023, të shtetases L. M, kundër Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) pranë Bashkisë Elbasan, me objekt pretendimin e diskriminimit për shkak të “moshës” dhe “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, L. M, në parashtrimet e sjella para Komisionerit shprehet se, është banore e qytetit të Elbasanit, është në pension dhe se posedon një pronë, njësi me nr. pasurie 2/74-N14, ZK 8521, e cila kufizohet me pronën e shtetases Y. A, njësi me nr. pasurie 2/155, ZK 8521, dhënë me qira shtetasit D. B, i cili është edhe ndërtuesi i shtesës.

Ajo shprehet se prej disa kohësh, në pronën e shtetases Y. A, kanë filluar punime të paligjshme, duke zaptuar truallin dhe hapësirën publike, duke ndryshuar kufijtë e skicës aktuale të planimetrisë së pronës dhe duke konsumuar një vepër penale, si ndërtim pa leje.

Subjekti ankues shprehet se: “Prej fillimit të punimeve i jam drejtuar institucioneve, IMT Elbasan, IKMT, Policisë së Shtetit, Platformës së Kryeministrisë, të cilat nuk kanë vepruar në kohë për marrjen e masave ligjore për ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë së krijuar. Të

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

gjitha institucionet kanë bashkëvepruar me njëra tjetrën duke mos zbatuar ligjin dhe duke devijuar kompetencat ligjore që ka secili prej tyre.

Të gjitha institucionet e mësipërme kanë legjitimuar ndërtimet pa leje të subjektit Y. A, dhënë me qira D. B, edhe pse ka ndërtuar në truallin dhe hapësirën publike, duke mos respektuar edhe hapësirat midis dy pallateve.

- *Njësia e Y. A, bazuar edhe në planimetrinë e saj, kufizohet me pronën time me një hark dhe jo ashtu siç e ka transformuar ajo.*
- *Njësia e Y. A, ka zënë një hapësirë të përbashkët boshe midis dy pallateve e cila shërben për kullimin e ujrave të shiut, gjë që sjell dëmtimin dhe lagështi të pronës si dhe zbatim të hapësirave të përbashkëta.*
- *Njësia e Y. A, është spostuar përpara duke zaptuar trotuarin e përbashkët, i cili i përket të gjithë banorëve dhe nuk është truall i pronës në fjalë.*
- *Njësia e Y. A, ka ndryshuar fasadën ballore nga xham në fasadë muri gipsi, duralumin dhe qepen.*

Bazuar në të gjitha këto shkelje kam kërkuar në vazhdimësi zbatimin e ligjit, pasi unë jam pensioniste, nuk kam as këmbë, as lekë për të vrapuar pas “miqve”. Unë kam vetëm pensionin dhe dyqanin tim e kam të trashëguar nga profesioni që kam ushtruar si fotografe prej 40 vitesh, dhe kjo është e vetmja pasuri që do ju lë fëmijëve. Nuk kam dashur të përfshij fëmijët në këtë konflikt me personin në fjalë, duke mos dashur t’i çenoi në punët ku ata punojnë. Personi është munduar të ndikojë edhe nëpërmjet njohjeve të tij si “flori-shitës” dhe të bëjë presione tek familjet e fëmijëve të mi që unë të hesht për këtë “masakër mjedisore, shëndetësore dhe morale” që po ndodh në qendër të Elbasanit. Kam që në muajin Tetor që mundohem të gjej drejtësi dhe ndihem e diskriminuar nga institucionet si e kanë trajtuar çështjen time, si person që nuk kam lidhje farefisnore me personat me pushtet që të mund ta zgjidhja çështjen në favorin tim. Jam me probleme shëndetësore të cilat më janë rënduar nga kjo situatë e krijuar dhe kërkoj drejtësi nga institucionet për problemin tim”.

Subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese:

“Kthimin në identitet të kufijve sipas planimetrisë së objektit të shtetases Y. A;

Lirimin e hapësirës së përbashkët midis dy pallateve; Lirimin e hapësirës publike të zaptuar para objektit tim; Të më respektohet e drejta e ushtrimit të aktivitetit në pronën time pa u cënuar dhe bllokuar fizikisht”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se:

“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual,

karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/b të Ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar në nenin 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 124/1 prot., datë 08.02.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe i ka kërkuar parashtrime IMT/Bashkisë Elbasan, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
- Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 84/1 prot, datë 15.02.2023, IMT/Bashkia Elbasan, ka njohur Komisionerin me qëndrimin e saj lidhur me pretendimet e subjektit ankues, duke cituar ndër të tjera, se:

“...Pranë IMT/Bashkia Elbasan ka patur ankesa të vazhdueshme nga znj. M në lidhje me disa punime ndërtimore që po zhvilloheshin nga D. B, në lagjen “Kongresi i Elbasanit”.

Nga IMT janë verifikuar ankesat e znj. M dhe nga verifikimi ka rezultuar se Y. A dispononte me certifikatë pronësie një objekt njësi në lagjen “Kongresi i Elbasanit”, objekt i lëshuar me qiran ga Y. A ndaj D. B.

Në lidhje me vendosjen e një qepeni në hyrje të objektit njësi si dhe veshjen me materiale gipsi duke bërë ndryshimin e fasadës së objektit pa u pajisur me leje nga organet kompetente në lagjen “Kongresi i Elbasanit”, nga IMT, Bashkia Elbasan janë marrë të gjitha masat administrative ndaj D. B.

Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm me nr. 180 dhe nr. serie 0001220, datë 07.12.2022 që IMT/Bashkia Elbasan ka marrë ndaj D. B, nuk është ekzekutuar, pasi aktualisht IMT nuk disponon asnjë mjet specifik për ekzekutimin e vendimeve për prishje.

Nga ana e IMT me Vendimin nr. 187, nr. serie 0000037, datë 07.12.2022 është vendosur dënimi i kundërvajtësit D. B me gjobë, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë”.

- NËpërmjet shkresave me nr. 113/1 prot., datë 20.02.2023 të Drejtorisë Rajonale të IKMT Elbasan dhe me nr. 206/6 prot., datë 23.02.2023 të IKMT, Komisioneri është njohur me kopjen e korrespondencës institucionale së mbajtur mes tyre, si dhe mes tyre dhe ankueses, duke i kthyer përgjigje, dhe njëherësh duke ia deleguar për kompetencë institucionit përgjegjës, IMT/Bashkia Elbasan; fakte këto për të cilat subjekti ankues është informuar rast pas rasti shkresërisht.
2. NËpërmjet shkresës me nr. 124/5 prot., datë 09.03.2023, Komisioneri ka kërkuar nga ana e IMT/Bashkisë Elbasan kopje të praktikave të ngjashme, si me rastin në fjalë kur nga ana e IMT, Bashkia Elbasan ka qenë e pamundur ekzekutimi i vendimeve për prishje të objekteve të kundraligjshme, për shkak se nuk ka disponuar mjete për ekzekutimin e vendimeve për prishje.
 - Në përgjigje të sa më sipër, IMT/Bashkia Elbasan ka informuar Komisionerin se: *“Nga IMT Elbasan nuk disponohet asnjë mjet specifik për ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve të kundërligjshme. Me shkresa përcjellëse i jemi drejtuar Bashkisë Elbasan që në planifikimin e buxhetit të parashikojë krijimin e një fondi për pajisjen e IMT me mjetin tip fadromë ose marrjen me qira të një mjeti të tip fadromë me krahë të gjatë dhe funksion matrapik, për të bërë prishjen e këtyre objekteve”*.
 3. NËpërmjet shkresës me nr. 124/7 prot., datë 30.03.2023, Komisioneri ka kërkuar sërish nga ana e IMT/Bashkisë Elbasan kopje të praktikave të ngjashme, si me rastin në fjalë kur nga ana e IMT, Bashkia Elbasan, gjatë vitit 2022 ka qenë e pamundur ekzekutimi i vendimeve për prishje të objekteve të kundraligjshme, për shkak se nuk ka disponuar mjete për ekzekutimin e vendimeve për prishje.
 4. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 124/8 prot., datë 05.04.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, që do të zhvillohet në datën 20.04.2023, ora 10:00, pranë Zyrës së Komisionerit.

Komisioneri kërkoi paraprakisht që gjatë seancës të sillej dokumentacioni i kërkuar prej tij, lidhur me kopjet e praktikave të ngjashme, si me rastin e ankueses, kur nga ana e IMT, Bashkia Elbasan, gjatë vitit 2022 ka qenë e pamundur ekzekutimi i vendimeve për prishje të objekteve të kundraligjshme, për shkak se nuk ka disponuar mjete për ekzekutimin e vendimeve për prishje.

- NËpërmjet shkresës me nr. 206/1 prot., datë 06.04.2023, IMT/Bashkia Elbasan informoi Komisionerin se, nga ana e këtij institucioni ka qenë e pamundur të bëhej ekzekutimi i vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme, për shkak se nuk ka disponuar mjete për ekzekutimin e vendimeve për prishje, dhe ka bashkëlidhur kopje të dy praktikave të ngjashme të rastit të shtetasit G. T, në fshatin Gjinar, për të cilin ishin ndërmarrë të njëjtët hapa proceduralë si për ankuesen, respektivisht:

Vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm me nr. 06 dhe nr. serie 00000065, datë 08.02.2023.

Vendim për dënim me gjobë me nr. 07, dhe nr. serie 00000067, datë 08.02.2023, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

E njëjat situatë është dokumentuar edhe për shtetasin K. T, për të cilin gjithashtu, nga ana e IMT/Bashkia Elbasan është ndërmarrë:

Vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm me nr. 14 dhe nr. serie 00000014, datë 31.03.2023.

Vendim për dënim me gjobë me nr. 15, dhe nr. serie 00000075, datë 31.03.2023, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

5. Seanca u zhvillua në datë 20.04.2023, me praninë e subjektit ankues, znj. Leonora Murra, në mungesë të përfaqësuesve të IMT/Bashkia Elbasan, si dhe me praninë e përfaqësuesit ligjor të Drejtorisë Rajonale të IKMT Elbasan, juristit E. SH.

Gjatë seancës dëgjimore, palët e pranishme iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsytimit të vendimit.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankueses nga ana e IMT/Bashkia Elbasan.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Subjekti ankues ka paraqitur ankesa të vazhdueshme drejtuar institucioneve të ndryshme, në lidhje me disa punime ndërtimore që po zhvilloheshin nga subjekti D. B, në lagjen “Kongresi i Manastirit”, në objektin e marrë me qira prej tij. Nga përmbajtja e akteve shkresore dhe fotografive të depozituara pranë KMD-së, evidentohet të jetë dokumentuar nga ankuesja, vendosja e një qepeni në hyrje të objektit njësi, në përdorim nga subjekti D. B, si dhe veshja me materiale gipsi, gjë që ka reflektuar ndryshime të fasadës së objektit.

Nga këqyrja e dokumentacionit evidentohet se ka patur një korrespondencë shkresore mes ankueses dhe insitucioneve të cilave ajo u është drejtuar lidhur me këtë problematikë. Sikurse rezulton nga citimi i akteve respektive më lart, problematika e ankueses është referuar për zgjidhje pranë organit kompetent IMT/Bashkia Elbasan, si dhe ka patur një sërë veprimesh të ndërmarra, nga kjo e fundit.

Bazuar në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit e burimeve ujore në të gjithë vendin, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

kundërligjshme, bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, të decentralizimit dhe subsidiaritetit, në bazë të ndarjes administrative.

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i organeve për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe i përgjegjësive të tyre.

Në nenin 4, të këtij Ligji, përcaktohen përgjegjësitë e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, duke parashikuar se:

“Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse. Për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara me ligj, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore mbështetet nga policia e njësisë vendore dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga njësia vendore”.

Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, janë të parashikuara në nenin 5, të Ligjit, si më poshtë citohet:

“Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

b) vendos gjoha, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati;

ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;

f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni. Fjala “ndërtim/punim”, sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që

ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit”.

VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga ana e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësive Vendore”, ka parashikuar në mënyrë të detajuar unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (më poshtë IKMT-ja) dhe ai i njësisë vendore, nga ku përgjegjësitë dhe mënyra e ushtrimit të kompetencave për IMT, pranë njësive vendore, specifikohen si më poshtë vijon:

- “a) Kryeinspektorët/inspektorët e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore....*
- i) kanë të drejtë të hyjnë dhe të ushtrojnë kontroll në mjediset ku kryhet/en ndërtimi/et...;*
 - b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:*
 - i) zbaton vendimet e marra nga organi i qeverisjes vendore në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim, brenda territorit nën juridiksionin e tij;*
 - ii) kryen kontrole në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike...;*

2. Kryeinspektori/inspektori i njësisë vendore, gjatë kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, i vlerëson shkëlqje të punimeve në ndërtim rastet e mospërputhjes së objektit në ndërtim me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik të zbatimit apo me deklarinimin paraprak të miratuar e të konfirmuar nga organi i autorizuar, si:

- a) ndërtimi i volumeve të tepërta në lartësi ose në gjerësi të objektit (shitesë kati ose shitesë anësore);*
- b) ndryshimet e përmasave në gjatësi, gjerësi, lartësi më të mëdha ose më të vogla se ato të miratuara;*
- c) ndryshimet në arkitekturën e fasadës së objektit, krahasuar me projektin e miratuar; ç) rrethimi i objektit jo sipas planorganizimit të miratuar;*
- d) mosrespektimi i kuotave të lartësisë së kateve me ato të miratuara;*
- dh) mungesat e masave të sigurimit teknik të objektit dhe të mbrojtjes së jetës së njerëzve;*
- e) ndotja e mjedisit nga ndërtimi i objektit.*

3. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i njësisë vendore, në bazë të planit të punës verifikon:

- a) vendosjen e tabelës së objektit me leje ndërtimi, me të dhënat përkatëse. Në kantierin e punimeve, në momentin e hapjes së tij, tabela vendoset në një vend të dukshëm me një lartësi jo më pak se 4 metra nga niveli i rrugës dhe në përmasa jo më të vogla se 1.3 metra gjerësi dhe 1.3 metra gjatësi, ku shkruhet në mënyrë të dukshme:*
 - i) emërtimi i plotë i strukturës dhe/ose zhvillimit që realizohet;*
 - ii) leja e ndërtimit/e zhvillimit;*

- iii) kodi i nënnjesisë strukturore, sipas Instrumentit të Përgjithshëm Vendor, në të cilin ndodhet zhvillimi;
- iv) të dhëna teknike për projektin, shoqëruar me planimetrinë e vendosjes së strukturës në parcelë dhe pamjen 3 D të strukturës;
- v) sipërfaqja e ndërtimit;
- vi) intensiteti i ndërtimit;
- vii) sipërfaqja e parcelës ose parcelave që preken nga zhvillimi;
- viii) numri i strukturave që krijohen nëse janë më shumë se një;
- ix) sipërfaqja rrugore që ndërtohet;
- x) numri i njësive të banimit nëse krijohen të tilla dhe sipërfaqja e përgjithshme e banimit;
- xi) numri i hapësirave të tjera nëse ka një tjetër funksion dhe sipërfaqja e përgjithshme për to;
- xii) të dhëna të tjera, që vlerësohen të nevojshme për të kuptuar projektin;
- xiii) emri i personit fizik ose juridik projektues, duke përmendur edhe arkitektin edhe konstruktorin, emrin e inxhinierit mbikëqyrës, përgjegjës të zbatimit të punimeve, së bashku me numrat përkatës të licencave;
- xiv) një numër telefoni për kontaktim sipas nevojës;
- xv) afati i punimeve, data e fillimit dhe e mbarimit të punimeve në objekt.

.....

7. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni, teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqëruar të vendimit.

.....

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore është i detyruar të njoftojë IKMT-në për çdo vendim të marrë për ndërtimet në zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare, të përkufizuara nga legjislacioni në fuqi, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit. IKMT-ja, nga data e njoftimit të parashikuar më sipër, vlerëson se:

- a) ekzekutimi i vendimit duhet të kryhet vetëm nga IKMT-ja, për mbrojtjen e objekteve dhe zonave me rëndësi kombëtare;
- b) ekzekutimi i vendimit duhet të kryhet nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore në bashkëpunim me IKMT-në;
- c) ekzekutimi i vendimit duhet të kryhet vetën nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore. Pas shqyrtimit, IKMT-ja njofton, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore për vlerësimin e bërë sipas paragrafit të dytë të kësaj pike”.

Bazuar në sa më lart, IMT/Bashkia Elbasan, në përmbushje të kompetencave dhe në ushtrim të detyrës së saj, ka kryer veprimet përkatëse në lidhje me verifikimin e ankesës së znj. M në terren, dhe në përfundim të vlerësimit për sa më sipër, ka ndërmarrë masa administrative kundrejt subjektit (D. B) për të cilin ishte paraqitur ankesa.

Në lidhje me vendosjen e një qepeni në hyrje të objektit njësi si dhe veshjen me materiale gipsi duke bërë ndryshimin e fasadës së objektit, pa u pajisur me leje nga organet kompetente në lagjen “Kongresi i Elbasanit”, nga IMT, Bashkia Elbasan janë marrë të gjitha masat administrative ndaj D. B, respektivisht si më poshtë:

- Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm me nr. 180 dhe nr. serie 0001220, datë 07.12.2022.
- Subjekti D. B, nuk ka ekzekutuar vullnetarisht vendimin e mësipërm, dhe në vijim, nga ana e IMT me Vendimin nr. 187, nr. serie 0000037, datë 07.12.2022 është vendosur dënimi i kundërvajtësit D. B me gjobë, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë”.

Nga informacioni i sjellë nga IMT/Bashkia Elbasan, rezulton se vendimi për prishjen e këtij objekti nga ana e tyre nuk është ekzekutuar, pasi aktualisht IMT nuk disponon asnjë mjet specifik për ekzekutimin e vendimeve për prishje.

Lidhur me situata të ngjashme krahasimore, IMT/Bashkia Elbasan ka depozituar edhe praktika të tjera, ku për raste që ka konstatuar ndërtime të kundërligjshme nga subjekte të ndryshëm, ka ndjekur dhe zbatuar të njëjtën procedurë si me ankuesen.

- Kështu, lidhur me situatën e shtetasit G. T, në fshatin Gjinar, për të cilin ishte konstatuar se ka kryer një ndërtim të kundërligjshëm, ka ndërmarrë të njëjtët hapa proceduralë, respektivisht:

Vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm me nr. 06 dhe nr. serie 00000065, datë 08.02.2023.

Vendim për dënim me gjobë me nr. 07, dhe nr. serie 0000067, datë 08.02.2023, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

- E njëjta situatë është dokumentuar edhe për shtetasin K. T, për të cilin gjithashtu, nga ana e IMT/Bashkia Elbasan është ndërmarrë:

Vendim për prishje të objektit të kundërligjshëm me nr. 14 dhe nr. serie 00000014, datë 31.03.2023.

Vendim për dënim me gjobë me nr. 15, dhe nr. serie 0000075, datë 31.03.2023, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

Nga ana tjetër, rezulton se IMT ka informuar për sa më sipër, personat e interesuar (përfshirë edhe ankuesen për problematikën e saj) edhe IKMT, ku ndër të tjera, shprehet se: “...*duke qenë se aktualisht IMT nuk disponon asnjë mjet specifik për ekzekutimin e vendimeve për prishje, kërkojmë nga ana juaj mbështetjen tuaj me mjetin fadromë për ekzekutimin e vendimeve për prishje...*”.

Nga përmbajtja e sa më sipër, si dhe parashtrimet e sjella nga IMT/Bashkia Elbasan, evidentohet se ky institucion nuk disponon mjetet përkatëse që duhet të shërbejnë për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme, sipas parashikimeve ligjore dhe rasteve specifike.

IMT, nga ana tjetër i është drejtuar shkresërisht Bashkisë lidhur me kërkesën që, në planifikimin e buxhetit të parashikojë krijimin e një fondi për pajisjen e IMT-së me mjetin tip fadromë ose marrjen me qira të mjeteve përkatëse teknike, sipas nevojës së diktuar nga specifikat e rasteve të paraqitura.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

- Nga ana e IMT/Bashkia Elbasan janë ndërmarrë veprime konkrete për problematikën e ngritur nga subjekti ankues;
- Janë marrë masat administrative respektive (vendim për prishje objekti të kundërligjshëm si dhe vendim me sanksion me gjobë për mos ekzekutim të vendimit për prishjen e objektit)
- Rasti i ankueses nuk është trajtuar në mënyrë të diferencuar, duke e disfavorizuar atë krahasimisht me rastet (e personat) e tjerë, ndodhur në kushte të ngjashme me të; (G. T dhe K. T)
- IMT problematikën reale të mungesës së mjeteve specifike që duhet të shërbejnë për ndërhyrje të posaçme në prishjet e objekteve të kundërligjshëm, nga ana e tyre e kanë ngritur edhe para instancave të tjera: si IKMT- duke kërkuar mbështetjen e tyre dhe Bashkisë Elbasan, si organ pranë së cilës ushtrojnë veprimtarinë dhe funksionin e tyre;

Por, pavarësisht sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, justifikimi i IMT-së, në lidhje me rastin specifik, pra, objektin e kundërligjshëm për të cilin ankuesja është ankuar, nuk është i justifikuar dhe i arsyeshëm, bazuar në arsyetimin e mëposhtëm.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe fotografive të depozituara, pranë KMD-së, Komisioneri vlerëson se, së pari, rasti në fjalë bën fjalë për vendosjen e një qepeni në hyrje të objektit njësi si dhe veshjen me materiale gipsi duke bërë ndryshimin e fasadës së objektit pa u pajisur me leje, dhe nuk kërkon mjete shumë të sofistikuara për ndërhyrjen për rregullimin e kësaj shtate, dhe se një shtatë e tillë mund të ndreqet duke treguar më shumë vullnet e iniciativë institucionale sesa mjete të sofistikuara (për këtë rast) për prishjen e fasadës prej gipsi. Komisioneri thekson se, një qëndrim të tillë, referuar këtij rasti specifikisht, mbajti edhe përfaqësuesi i DRIKMT Elbasan, i cili evidentoi se, nga konstatimet e bëra prej tyre, një ndërhyrje e tillë mund të bëhej edhe pa nevojën e mjeteve të tilla si fadroma.

Së dyti, çka është edhe më thelbësorja, subjektit ankues, edhe pse në një farë mënyre i është dhënë të drejtë në lidhje me sa ka pretenduar, sërish nuk i është zgjidhur problematika në thelb. Vërtet ndaj subjektit D. B, është marrë sanksion me gjobë, por kjo në vetvete, nuk kënaq interesin e ankueses dhe nuk zgjidh efektivisht dhe përfundimisht problematikën e saj.

Në këtë kontest, Komisioneri vlerëson se, nga ana e IMT-së nuk janë bërë përpjekjet e veprimet e duhura, për të përmbushur kërkesën e ankueses, por edhe detyrën funksionale për të cilën ky organ është krijuar dhe funksionon.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, IMT/Bashkia Elbasan, ka trajtuar në mënyrë të padrejtë subjektin ankues, në lidhje me trajtimin e zgjidhjen efektive e përfundimtare të problematikës së ngritur prej saj.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2³, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

B. 1 Gjendja shëndetësore dhe moshë

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, këto dy shkaqe të poseduara nga subjekti ankues, konsiderohen si shkaqe të mbrojtura, pasi parashikohen si të tilla në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se i mbart ato.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

- Referuar Vërtetimit nr. 1178, të datës 11.04.2029, të KMCAPI pranë DRSSH Elbasan, rezulton se, L. M, me dosje pensioni 124812, përfiton pension invaliditeti.

³“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të gjendjes shëndetësore.

- Referuar moshës së L. M (gjeneraliteteve të pasqyruara në kartën e identitetit), ajo është e datëlindjes 23.09.1951. Në momentin e paraqitjes së ankesës pranë IMT/Bashkia Elbasan (2022) ankuesja ka patur moshën 71 vjeç. Pra, ankuesja gëzon “statusin” e pensionistes, gjë e cila pasqyrohet edhe në Vërtetimin e KMCAJ pranë DRSSH Elbasan, ku citohet se dosja e saj e pensionit mban nr. 124812.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të moshës.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij.
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*

Në të njëjtën frymë është dhe ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë të kundërtën.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues, në radhë të parë Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pajustificuar objektivisht nga ana e IMT/Bashkia Elbasan, e cila nuk ka vepruar në mënyrë efektive për zgjidhjen e problematikës së saj.

C.1 Lidhja midis trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm me gjendjen shëndetësore dhe moshën, si shkaqe të mbrojtura.

Për të vërtetuar faktin se ankuesja është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e IMT/Bashkia Elbasan, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkaqeve të mbrojtura nga ligji 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe trajtimit të padrejtë të ankueses.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës⁴, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë nga ana e IMT/Bashkia Elbasan, në lidhje me trajtimin e zgjidhjen e problematikës së saj, në kuadër të mosveprimit me efektivitet nga ana e tyre, për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm të objektit në përdorim të subjektit D. B.

Por, pavarësisht konstatimit të këtij fakti, ankuesja nuk arriti të provojë dhe dokumentojë se gjendja shëndetësore dhe moshja e saj, kanë shërbyer si shkaqe për të cilat ajo është diskriminuar nga ana e IMT/Bashkia Elbasan.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, pretendimi për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore dhe moshës, bazuar vetëm në

⁴ Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

faktin se ankuesja i posedon ato, është i pamjaftueshëm për të ngritur një prezumim *prima facia* dhe për të krijuar bindjen se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesja është si rezultat i posedimit të këtyre shkaqeve dhe se, në mungesë të tyre, ankuesja do të ishte trajtuar ndryshe.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk të çojnë apriori në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji⁵.

Në bazë të provave të administruara Komisioneri vlerëson se, nuk rezulton të ketë një lidhje shkakësore midis trajtimit të padrejtë, të cilit i është nënshtruar ankuesja dhe shkaqeve të pretenduara prej saj. Për më tepër, Komisioneri gjatë trajtimit të ankesës, ka evidentuar edhe raste të tjera për të cilat IMT-ja, ka ndjekur të njëjtën praktikë e procedurë, në lidhje me marrjen e masave administrative kundrejt subjekteve që ishin konstatuar se kanë bërë ndërtime të kundërligjshme.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, sjellja e IMT-së ndaj ankuses mbetet në kuadër paligjshmërie, por nuk provohet që ajo të jetë motivuar nga shkaqet e pretenduara prej saj. Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t'u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit ankues për diskriminim, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për shkak të “gjendjes shëndetësore”, dhe “moshës”, nga ana e IMT-së, nuk qëndron, pasi nuk rezultoi e provuar që IMT/Bashkia Elbasan, të ketë shkëlur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, L. M, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e IMT/Bashkia Elbasan, për shkaqet e pretenduara prej saj.

⁵ Për analogji citojmë vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Nr. 50, datë 23.03.2021, Nr. 91, datë 28.05.2021, Nr. 66, datë 07.04.2022, Nr. 82, datë 26.04.2022, Nr. 98, datë 23.05.2022, Nr. 160, datë 15.08.2022.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: Moshë, gjendja shëndetësore